VENDIM
Nr.1043, datë 22.12.2010

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE NË KULTURAT BUJQËSORE TË FERMERËVE TË QARKUT KORÇË, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE TË SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT DHE DËMTIMI I ARGJINATURËS SË LUMIT DEVOLL, GJATË MUAJVE SHKURT-MARS 2010, FAZA E DYTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, si rrjedhojë e përmbytjeve nga reshjet e shiut në komunat Libonik, Vreshtas dhe Pirg, të qarkut Korçë, në shumën 30 242 214.5 (tridhjetë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e dyqind e katërmbëdhjetë pikë pesë) lekë.
2. Miratimin e listave të familjeve të komunave të qarkut Korçë, së bashku me shumën përkatëse të kompensimit të dëmeve, sipas lidhjeve 1, 2, 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Efektet që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
4. Ngarkohet këshilli i qarkut Korçë për kryerjen e pagesave për personat përfitues, sipas pikës 2 të këtij vendimi.
5. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, këshilli i qarkut Korçë dhe institucioni i prefektit të qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha